



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:026169

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05843053

KPPP.nr. 146/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit ADA GROUP Sh.A., me numër unik identifikues 811373000 dhe me seli në Prishtinë, rr. “Ahmet Krasniqi”, Bll C2-H1, nr. 4, kundër debitorit Komuna e Vushtrrisë me seli në Vushtri, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 314/23 të datës 15.12.2023, të lejuar nga Përbaruesi Privat Isa Shala me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 21.06.2024, merr këtë.

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Komuna e Vushtrrisë, ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përbarimor P.nr. 314/23 i datës 15.12.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Isa Shala, sa i përket detyrimit në shumë prej 1,189.80 EUR dhe PËRFUNDOHET procedura në këtë pjesë të përbarimit.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Komuna e Vushtrrisë, ashtu që MBETET NË FUQI pjesërisht Urdhri Përbarimor P.nr. 314/23 i datës 15.12.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Isa Shala, sa i përket detyrimit në shumë prej 327.80 EUR.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ADA GROUP Sh.A., me datë 15.12.2023 ka lëshuar Urdhrin përbarimor P.nr. 314/23 me të cilin ka lejuar përbarimin, në bazë të dokumenteve: Fatura nr. 21-SHV01-100-1657, e datës 18.10.2021; Fatura nr. 21-SHV01-100-1435, e datës 10.09.2021; Fatura nr. 22-SHV01-100-505, e datës 09.06.2022; Fatura nr. 22-

SHV01-002-854, e datës 15.06.2022 dhe Fatura nr. 21-SHV01-002-1828, e datës 18.11.2021, duke urdhëruar debitorin që në afat prej shtatë (7) ditëve nga data e dorëzimit të urdhrit t'ia paguaj kreditorit borxhin e papaguar nga faturat e lartcekura në shumë prej 1,517.60 EUR € (njëmijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë euro e gjashtëdhjetë cent), si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi deri në përfundim e procedurës.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar urdhrin përbarimor me arsyetim se të gjitha obligimet financiare të pretenduara nga kreditori për furnizim janë përmbushur në bazë të dokumentacionit të cilin e posedon shërbimi për pagesa në Komunën e Vushtrrisë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, duke bashkangjitur kuponët e shpenzimeve – pagesave në llogarinë e kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të anulohet.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata nga shkresat e lëndës konstatoi se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përbarim është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit, dhe atë në vlerë prej 1,189.80 EUR nga totali prej 1,517.60 EUR. Këtë fakt gjykata e vërtetoi nga dëshmitë e pagesave të bashkangjitura nga debitori në prapësim dhe atë nga kuponët e lëshuar me datë 09.12.2021, me datë 12.07.2022 dhe me datë 20.04.2022 nga të cilat vërtetohet se debitori ka përmbushur faturat me nr. nr. 22-SHV01-100-505 e datës 09.06.2022, nr. 22-SHV01-002-854 të datës 15.06.2022

dhe faturën nr. 21-SHV01-002-1828, e datës 18.11.2021, vlera e përbashkët e të cilave arrin shumën prej 1,189.80 EUR.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”* vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi duke aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit për shkak se Urdhri Përmbarimor P.nr. 314/23 i datës 15.12.2023, në shumën prej 1,189.80 EUR është bërë i pa efekt juridik në këtë pjesë të përmbarimit. Ndërsa vendimin mbi përfundimin e procedurës përmbarimore në këtë pjesë të përmbarimit, Gjykata e mbështeti në nenin 66.4 të LPP-së i cili përcakton se *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor në shumën prej 327.80 EUR, shumë kjo që buron nga faturat nr. 21-SHV01-100-1657 të datës 18.10.2021 dhe fatura nr. 21-SHV01-100-1435, e datës 10.09.2021 pasi që gjeti se të njëjtat, i plotësojnë të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 29 par.3 të LPP-së dhe po ashtu janë dorëzuar në origjinal në përputhje me nenin 37 të LPP-së. Në anën tjetër, debitori, nuk ka ofruar dëshmi se faturat e lartcekura i ka përmbushur.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti ka përmbushur në tërësi detyrimin që rrjedh nga faturat objekt i propozimit për përmbarim, mirëpo gjeti se pagesa në vlerë prej 156.20 EUR të cilën e ka bashkangjitur në prapësim, në përshkrimin e saj i referohet faturës nr. 21-SHV01-100-1637 dhe e cila faturë nuk është objekt përmbarimi në këtë çështje përmbarimore, andaj të njëjtën pagesë nuk e morri për bazë si dëshmi për pagesën e borxhit të mbetur ndaj debitorit.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 146/24, datë 21.06.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE. Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.